Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-65
Datë: 08.02.2018

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 9, 12, 13, 14, 15, dhe 18, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 22.01.2018 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave në Prishtinë, i ka plotësuar kushtet e caktuara me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 142/01, datë 19. 08. 2016, për të marr akreditimin dhe aprovimin për kualifikimin:

   1.1. Auditor i brendshëm në sektorin publik.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet e raporteve të ekspertëve dhe kushteve të caktuara nga KD i AKK-së.
Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

3. Vendimi u dërgohet:

   - Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave;
   - AKK.

Kryetari i KD së AKK
Bedri Xhafa